



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT FIER

PERMBLEDHJE

Kreu I	Dispozita te pergjithshme.....	faqe 3
Kreu II	Selia e mbledhjeve.....	faqe 4
Kreu III	Perberja, krijimi, mebnrya e organizimit, kompetencat dhe detyrat e Keshillit te Qarkut.....	faqe 4
Kreu IV	Kryesia e Keshillit te Qarkut.....	faqe 8
Kreu V	Kryetari I Keshillit te Qarkut.....	faqe 10
Kreu VI	Sekretari I Keshillit te Qarkut.....	faqe 10
Kreu VII	Komisioneret e Keshillit te Qarkut.....	faqe 11
Kreu VIII	Te drejtat e keshilletarit.....	faqe 13
Kreu IX	Nisma ligjore per marrjen e vendimeve.....	faqe 15
Kreu X	Marredheniet e Keshillit me administraten.....	faqe 17
Kreu XI	Mbledhjet e Keshillit te Qarkut.....	faqe 17
Kreu XII	Disiplina e mbledhjeve.....	faqe 20
Kreu XIII	Votimi.....	faqe 21
Kreu XIV	Dispozita perfundimtare.....	faqe 25

RREGULLORE

“PER ORGANIZIMIN E VEPRIMTARISE SE KESHILLIT TE QARKUT FIER”.

Keshilli i Qarkut organizon dhe realizon veprimtarine e tij ne baze te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Ligjit Nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” si dhe ne perputhje me rregulloren e miratuar prej tij.

Per çeshtje qe nuk gjejne zgjidhje ne kete rregullore, Keshilli i Qarkut merr vendime te veçanta.

KREU I

Dispozita te pergjitheshme

Cfare perfaqeson Keshilli i Qarkut dhe Funkzioni i tij

Neni 1

Qarku eshte njesi e nivelit te dyte te qeverisjes vendore.

Neni 2

Qarku perfaqeson nje unitet administrativo-territorial, te perbera nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa te perbashketa. Qarku i Fierit perbehet nga tre rrethe, Fier, Lushnje dhe Mallakaster te cilat kane ne perberjen e tyre 6 bashki: 1-Bashkia Fier, 2-Bashkia Lushnje, 3- Bashkia Mallakaster, 4- Bashkia Divjake, 5-Bashkia Patos dhe 6-Bashkia Rroskovec.

Kufijte e Qarkut perputhen me kufijte e bashkive qe perfshihen ne te.

Neni 3

Organi perfaqesues i Qarkut Fier eshte Keshilli i Qarkut Fier. Funkzionet ekzekutive ne Qark kryhen nga Kryetari dhe Kryesia e Keshillit te Qarkut.

Neni 4

Organi perfaqesues i Qarkut Fier krijohet me perfaqesues nga organet e zgjedhura te Bashkive qe e perbejne ate, sipas menyres se percaktuar ne Kushtetute dhe ne Kreun XIII te Ligjit Nr.139/2015, “Per Veteqeverisjen Vendore”

Neni 5

Kryetari dhe Kryesia e Keshillit te Qarkut Fier zgjidhen nga Keshilli i Qarkut sipas menyres se percaktuar ne ligj.

Neni 6

Keshilli i Qarkut mund te ndermarre nisma me interes publik vendor per çdo çeshtje qe nuk i ndalohet me ligj ose qe nuk i eshte dhene ekskluzivisht me ligj nje organi tjetër shteteror.

Keshilli i Qarkut i ushtron kompetencat e tij nepermjet vendimeve, urdheresave dhe urdherave.

Neni 7

Funksionet e veta te Qarkut jane ndertimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shteterore ne nivel qarku, si dhe cdo funksion tjetër i vete i dhene me ligj.

Qarku i Fierit ushtron te gjitha funksionet qe i delegohen nga nje ose me shume bashki brenda territorit te tij, sipas nje marreveshje te lidhur dhe funksionimit e qeverisjes vendore.

Neni 8

Qarku krijon te ardhurat nga burimet e veta vendore, dhe nga ndarja e te ardhurave kombetare.

Neni 9

Te ardhurat nga burimet e veta vendore perbehen nga:

1. Transfertat e pakushtezuara perfshire kuotat e anetaresise se bashkive perberese, te percaktuara ne rregullore dhe buxhetin vjetor te Qarkut per kryerjen e funksioneve te veta dhe te perbashketa.
2. Transfertat e kushtezuara per kryerjen e funksioneve dhe kompetencave te deleguara perkatese nga bashkite dhe komunat perberese.
3. Taksa dhe tatime te vendosura ne nivel qarku, te percaktuara ne perputhje me ligjin.
4. Tarifat per sherbimet publike te kryera nga Qarku, si dhe nga burime te tjera te percaktuara ne nenin 77te Ligjit Nr. 139/2015, “Per Veteqeverisjen Vendore”.

Neni 10

Kriteret dhe normat per krijimin dhe administrimin e te ardhurave nga burimet e veta vendore jane te ngjashme me ato te percaktuara per te ardhurat nga burimet vendore te Bashkive.

Neni 11

Te ardhurat e Qarkut nga ndarja e te ardhurave kombetare krijohen dhe administrohen sipas menyres se percaktuar me ligj.

KREU II

Perberja, krijimi, menyra e organizimit te Keshillit te Qarkut

Neni 12

Keshilli i Qarkut Fier perbehet nga **31** anetare, perfaqesues te Bashkive qe bejne pjese ne Qark.

Neni 13

Kryetaret e Bashkive qe bejne pjese ne qark jane kurdohere anetare te Keshillit te Qarkut.

Neni 14

Funksioni i anetarit te Keshillit te Qarkut eshte i papajtueshem me çdo funksion ne administraten e Keshillit te Qarkut.

Neni 15

Per zgjedhjen e Kryetarit te Keshillit te Qarkut behet propozimi i kandidaturave per kryetar, me kandidatura alternative me nje numer te fiksuar nga vete keshilli apo pa kufizim.

Behen dhe evidentohen propozimet e kandidateve, plotesohen fletevotimet dhe votohet me votim te fshehte. Pas votimit komisioni i votimit, i cili perbehet nga 3-5 anetare ne menyre publike, hap kutine e votimit dhe komunikon rezultatin e votimit. Konsiderohet i zgjedhur kryetar, kandidati qe ka fituar shumicen e votave te pjesemarresve ne votim.

Nese asnje kandidat nuk e siguron shumicen e kerkuar, behet nje votim i dyte me dy kandidatet, qe ne raundin e pare kane fituar numrin me te madh te votave.

Po e njejta procedure ndiqet per Zv.Kryetarin e Keshillit te Qarkut.

Neni 16

Mandatin e Keshilltarit te Qarkut e fitojne te gjithë kryetaret e bashkive perberese te tij, menjehere me marrjen e mandatit perkates.

Neni 17

Anetarit te Keshillit te Qarkut i mbaron mandati kur:

1. Humbet mandatin si kryetar i bashkise.
2. Mandati i anetarit hiqet nga keshilli bashkiak perkates.
3. Vetetohet se mandati eshte fituar ne menyre te paligjshme.
4. Largohet ose jep doreheqje me vullnetin e tij.

Neni 18

Ne rastin e krijimit te vendit vakant, qe lidhet me humbjen e mandatit te anetarit te Keshillit te Qarkut nga nje anetar i Keshillit te Bashkie, ai zevendesohet nga Keshilli Bashkiak perkates.

Ne rast se vendi vakant krijohet nga humbja e mandatit te anetarit te Keshillit te Qarkut nga nje Kryetar Bashkie ne 6 muajt e fundit te mandatit, vendin e tij e ze Kryetari i zgjedhur nga Keshilli Bashkiak perkates.

Neni 19

Kryesia e Keshillit te Qarkut Fier perbehet nga Kryetari, Zv. Kryetari dhe 5 anetare te tjere.

Neni 20

Kryetari dhe Zv.Kryetari zgjidhen dhe shkarkohen me shumicen e votave te anetareve te pranishem ne mbledhje. Kur nuk arrihet shumica e kerkuar, kalohet ne rivotim ndermjet dy kandidatave qe kane fituar numrin me te madh te votave ne raundin e pare.

Anetaret e tjere te kryesise se Keshillit te Qarkut zgjidhen dhe shkarkohen me votim, me liste shumemerore kandidatesh dhe shpallen fitues kandidatet qe kane marre me shume vota.

Neni 21

Kryesia e Keshillit te Qarkut thirret ne mbledhje nga Kryetari, jo me pak se nje here ne muaj

Neni 22

Mbledhjet e kryesise jane te vlefshme kur marrin pjese me shume se gjysma e anetareve.

Neni 23

Kryesia e Keshillit te Qarkut per realizimin e funksioneve te Qarkut dhe ne zbatim te vendimeve te keshillit te tij:

- a) Ushtron te gjitha kompetencat me perjashtim te atyre qe i jane dhene shprehimisht Keshillit te Qarkut.
- b) Miraton projektaktet dhe materialet e tjera per mbledhjen e Keshillit te Qarkut, ne perputhje me rendin e dites, te percaktuar nga keshilli si dhe probleme qe kerkon ajo vete.
- c) Raporton ne keshill per gjendjen ekonomiko-financiare te pakten çdo 6 muaj ose me shpesh, kur kjo kerkohet nga keshilli.
- d) Raporton ne Keshill sa here kerkohet prej tij per probleme te tjera qe kane te bejne me funksionet e Qarkut.
- e) Ushtron te drejttat dhe siguron plotesimin te te gjitha detyrimeve qe i jane ngarkuar Qarkut si person juridik.

Neni 24

Ne ushtrimin e kompetencave te saj, Kryesia e Keshillit te Qarkut nxjerr vendime te cilat miratohen nga shumica e anetareve te pranishem. Vendimet marrin fuqi detyruese per tu zbatuar nga te gjitha organet dhe personat e ngarkuar pasi shpallen publikisht ose behen te njohura subjekteve te interesuara.

Vendimet e Kryesise duhet te miratohen ne mbledhjen me te afert te Keshillit te Qarkut dhe ne rast se ato nuk miratohen, mund te humbasin fuqine e tyre qe nga fillimi.

Neni 25

Kryetari i Keshillit te Qarkut

Kryetari i Keshillit te Qarkut perfaqeson Keshillin e Qarkut ne marredhenie me organet shteterore, me organet e njesive te qeverisjes vendore, me persona fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, si dhe ushtron keto kompetenca:

- a) Kryeson mbledhje e Keshillit te Qarkut
- b) Nenshkruan te gjitha aktet e Keshillit dhe te Kryesise se Keshillit si dhe procesverbalet e mbledhjeve te Keshillit dhe te Kryesise.
- c) Siguron zbatimin e vendimeve te Keshillit te Qarkut dhe Kryesise te tij.
- d) Ne perputhje me tematiken e mbledhjeve te Keshillit te Qarkut dhe Kryesise te tij ndjek pergatitjen e raporteve, projekt-vendimeve dhe materialeve te tjera te nevojshme.

- e) Drejton Administraten e Keshillit te Qarkut dhe pergjigjet para Keshillit per funksionimin e saj.
- f) Emeron dhe shkarkon personelin e Administrates te Keshillit te Qarkut, pervec rasteve te parashikuara ndryshe ne ligjin Nr.152/2013”Statusi i Nenpunesit Civil”.
- g) Garanton kryerjen e funksioneve qe i jane dhene me ligj Keshillit te Qarkut.
- h) Merr masa dhe siguron funksionimin normal te te gjithe strukturave te Keshillit, te mbledhjeve te Keshillit dhe Kryesise te tij.
- i) Ushtron kompetenca te tjera qe i ngarkohen atij me ligj, nga Keshilli i Qarkut ose nga Kryesia e tij.
- j) Kryetari i Keshillit te Qarkut nxjer urdhra me karakter individual.
- k) Ne mungese te Kryetarit, funksionet e tij kryhen nga Zv.Kryetari i Keshillit te Qarkut.

Neni 26

Sekretari i Keshillit te Qarkut

Sekretari i keshillit te Qarkut emerohet dhe lirohet nga Keshilli i Qarkut, procedura e zgjedhjes eshte me votim te fshehte pas shpalljes se kandidaturave, jo me pak se dy.

Sekretari i Keshillit te Qarkut eshte pergjegjes per:

- a) Mbajtjen e dokumentave zyrtare te Keshillit te Qarkut
- b) Ndjekjen e punes per pergatitjen e materialeve te mbledhjeve sipas rendit te dites.
- c) Njoftimin per zhvillimin e mbledhjeve te Keshillit te Qarkut
- d) Shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve te nxjerra nga Keshilli i Qarkut
- e) Pergatitjen e seancave te keshillimit me bashkesine
- f) Mbikqyrjen dhe respektimin e rregullores se funksionimit te Keshilli i Qarkut
- g) Sekretari i Keshilli i Qarkut kryen cdo funksion tjeter qe i caktohet nga vete Keshilli i Qarkut.

Neni 27

Grupet e Keshilltareve

Keshilltaret mund te formojne grupe ne perputhje me perkatesine partiake apo orientimet e tyre politike.

Neni 28

Per formimin e nje grupi, numri minimal i keshilltareve duhet te jete 5. Grupe keshilltaresh ne baze te interesave lokale, etnike, fetare, apo profesionale, nuk mund te formohen.

Neni 29

Tek kryetari i Keshillit te Qarkut cdo grup paraqet vendimin per formimin e grupit, listen e anetareve qe jane perfshire ne grup dhe ne listen e drejtuesve te grupit.

Kryetari i Keshillit te Qarkut ben shpalljen e krijimit dhe drejtuesin e tij ne mbledhjen e Keshillit.

Grupet e keshilltareve, ndryshimet ne perberjen e tyre dhe drejtuesve te tyre pasqyrohen ne rregjister te vecante.

Neni 30

Cdo keshilltar mund te marre pjese vetem ne nje grup keshilltaresh.

Neni 31

Drejtuesi i grupit percakton keshilltaret qe do te diskutojne ne emer te grupit dhe rradhen e tyre. Ky rregull, nuk kufizon te drejten e keshilltarit per te diskutuar individualisht, kur ai kerkon te diskutoje.

Neni 32

Komisionet e Keshillit te Qarkut

Komisionet jane organe te Keshillit. Ato kryejne funksione per njohjen e gjendjes, realizimin e iniciatives, dhe kontrollit te keshillit. Komisione e keshillit jane te perhershme ose te perkohshme.

Neni 33

Keshilli i Qarkut ka keto komisione te perhershme:

- Komisionin e Mandateve
- Komisionin Ekonomiko-financiar dhe i buxhetit
- Komisioni i Programimit, zhvillimit dhe sherbimeve publike
- Komisioni per mbrojtjen civile

Neni 34

Per funksionimin sa me mire te Komisioneve te perhershme, Keshilli i Qarkut mund te beje ndryshime persa u perket objektit te punes se komisioneve, numrit dhe perberjes.

Numri dhe anetaret e komisioneve zgjidhen nga anetaret e keshillit me propozim, te kryetarit te Keshillit te Qarkut pas konsultimeve paraprake me kryetaret e grupeve.

Anetaresia dhe perberja e komisioneve caktohet nga keshilli ne perputhje me karakterin e veprimtarise se komisioneve.

Anetari i Keshillit te Qarkut mund te beje pjese ne dy komisione te perhershme. Keshilltari mund te marre pjese ne rolin e ekspertit, kur kerkohet nga nje komision tjetër pa qene anetar i tij.

Neni 35

Anetaret e kryesise se Qarkut nuk mund te marrin pjese ne keto komisione.

Neni 36

Ne komisione mund te afrohen edhe persona te tjere te jashtem si eksperte per konsultime. Drejtuesit e komisioneve mbajne lidhje pune me drejtuesit e komisioneve te tjera dhe drejtuesit e keshillit.

Komisionet e perhershme pergatisin projekt-vendime, projekt-rregullore, projekt-urdheresa dhe i paraqesin ne Keshillin e Qarkut per miratim.

Neni 37

Komisionet e perhershme diskutojne projekt-vendimet e pergatitura, te shperndare nga kryetari i Keshillit, pergatisin raporte per to dhe i propozojne keshillit: pranimin, plotesimin, rrezimin ose ndryshimin e tyre.

Neni 38

Komisionet e perhershme studiojne dhe analizojne efektivitetin e akteve te Keshilli i Qarkut (rregulloreve, vendimeve, urdheresave).

Neni 39

Komisionet e perhershme shqyrtojne raportet qe vijne ne adrese te Keshillit te Qarkut.

Neni 40

Nenpunesit e administrates se Qarkut jane te detyruar tu japin te gjitha te dhenat qe u kerkohen nga komisionet ne perputhje me aktet

Neni 41

Kryetari ose Zv.Kryetari me iniciativen e vete mbledhin komisionet e perhershme, gjithashtu mund te mblidhet me kerkesen e 1/3 te anetareve te komisionit, dhe me urdher te kryetarit te Keshilli i Qarkut.

Neni 42

Ne mbledhjet e Komisioneve mund te marrin pjese pa te drejte vote dhe keshilltaret qe nuk jane anetare komisioni.

Neni 43

Drejtoria qe paraqet projekt ne Keshill, merr pjese ne komisione ne kohen e shqyrtimit te tyre duke caktuar perfaqesuesit e vete te cilet japin sqarimet e nevojshme.

Neni 44

Ne komisionet, vendimet si rregull merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem me votim te hapur. Mbledhjet jane te vlefshme kur marrin pjese me shume se gjysma e anetareve.

Neni 45

Komisionet e perhershme mund te organizojne mbledhje te perbashketa dhe te drejtohen me konsensus nga kryetari i nje prej komisioneve.

Neni 46

Ne mbledhjet e perbashketa, cdo komision merr ne menyre te vecante vendime per ceshtjet e shqyrtuara.

Neni 47

Per cdo akt apo projekt te vecante qe shqyrton, Komisioni ben raportin e vete dhe ja paraqet Keshillit.

Neni 48

Raportimi para Keshillit behet nga nje anetar i komisionit qe percaktohet nga komisioni me propozim te drejtuesit te tij.

Neni 49

Ne mbledhjet e komisioneve te perhershme mbahet protokolli i cili firmoset nga Kryetari dhe ne mungese nga Zv.Kryetari i cili ka drejtuar mbledhjen.

Neni 50

Komisionet e perkohshme, formohen per studimin apo pergatitjen e nje projekt vendimi te caktuar.

Neni 51

Menyra e krijimit dhe funksionimit te komisionit te perkohshem jane te njejta me ato te komisionit te perhershem.

Kreu VI **Mbledhjet e KESHILLI I QARKUT**

Neni 52

Keshilli i Qarkut ushtron kompetencat nga casti i konstituimit te tij deri ne konstituimin e keshillit pasardhes.

Neni 53

Mbledhja e rradhes e Keshillit te Qarkut behet jo me pak se nje here ne tre muaj. Mbledhjet zhvillohen sipas programit te punes qe ben Keshilli.

Neni 54

Keshilli i Qarkut mblidhet jashte rradhe me kerkese te :

- Kryetarit te saj
- Te Kryesise se Keshillit
- te 1/3 te anetareve te Keshillit
- te Prefektit per ceshtje qe lidhen me ushtrimin e funksioneve te tij.
- Keshilltaret duhet te pajisen me materiale.

Neni 55

Thirrja e mbledhjes se Keshillit behet nga Kryetari.

Njoftimi per mbledhjen e Keshillit behet si rregull jo me pak se 10 dite para dates se zhvillimit te mbledhjes.

Njoftimi permban daten e mbledhjes, oren, vendin dhe rendin e dites.

Mbledhja e Keshillit te Qarkut quhet e vlefshme kur ne te merr pjese shumica e te gjithe anetareve te tij.

Neni 56

Kur ekziston nje konflikt interesash, Keshilltari i Qarkut nuk merr pjese ne shqyrtimin dhe miratimin e aktit te keshillimit, kur ai vete ose bashkeshorti, prinderit, femijet, motra, vellezerit, vjehri, vjehhra, dhendri, nusja, e tij kane nje interes pasuror apo cdo lloj interesi tjeter me ceshtjen qe diskutohen ne keshill.

Neni 57

Keshilli i Qarkut zhvillon mbledhje te hapura per publikun, si dhe respekton te drejten e publikut per tu informuar .

Neni 58

Mbledhjet e Keshillit te Qarkut jane publike, vete keshilli mund te vendose me shumice votash, qe mbledhje te vecanta, behen te mbyllura. Mbledhjet mbi problemet e buxhetit zhvillohen kurdohere te hapura.

Propozimi per mbledhje te mbyllura mund te behen nga kryetari i Keshillit ose 1/3 e anetareve.

Neni 59

Personat e jashtem ne kohen e mbledhjes qendrojne ne vendet e caktuara per ta dhe nuk kane te drejte te shkelin rregullat e mbledhjes per cfaredo arsye.

Neni 60

Kryetari i Qarkut, ose Zv.Kryetari qe drejton mbledhjen, vendos rregull dhe qetesi. Per persona te vecante, qe pengojne zhvillimin e mbledhjes mund te urdheroje qe te nxirren nga salla e mbledhjes.

Neni 61

Kryetari i Keshillit te Qarkut hap mbledhjen e keshillit kur eshte siguruar pjesmarrja e me shume se gjysmes se keshilltareve dhe u jep fjalen diskutanteve.

Neni 62

Kur kryetari konstaton se nuk eshte siguruar pjesemarrja e shumices se keshilltareve, ne mbledhje, e pezullon ate.

Neni 63

Kryetari i Keshillit ne cdo mbledhje njofton keshilltaret per aktet e reja qe jane paraqitur ne keshill dhe autoresine e tyre.

Neni 64

Kryetari nuk drejton mbledhjen ne ato raste kur diskutohet per ceshtje qe lidhen me personin e tij, ose ne rastet kur ai merr pjese direkt ne debat.

Asnje keshilltar nuk mund te diskutoje pa ju dhene fjala nga kryetari.

Fjala kerkohet me ngritje dore ose me shkrim, paraparakisht.

Neni 65

Kryetari i keshillit harton listen me emrat e personave qe kane bere kerkese per diskutim dhe percakton rradhen e diskutimeve ne perputhje me kohen e berjes se kerkeses.

Neni 66

Per ceshtje proceduriale, fjala jepet njehere. Keto kane te bejne me propozime per ndryshim apo plotesim ne rregullin e zhvillimit te mbledhjes. Ceshtjet proceduriale paraqiten sakte dhe shkurt, pa hyre ne thelbin e problemeve ne shqyrtim.

Neni 67

Keshilltaret flasin ne tribune, ose nga vendi. Kur diskutanti shmanget nga tema, kryetari e paralajmeron dhe nese shkelja vazhdon, atij i hiqet e drejta e fjales per ate problem ne rendin e dites.

Neni 68

Keshilltari nuk mund te diskutoje me shume se nje here per problemin qe shqyrtohet.

Neni 69

Koha e zgjatjes se diskutimeve nuk duhet te jete me shume se 5 minuta me perjashtim te rasteve kur ne kete rregullore parashikohet ndryshe.

Neni 70

Kur shihet e arsyeshme, per ceshtje konkrete, koha e diskutimeve mund te percaktohet paraparakisht nga kryetari i keshillit dhe kryetaret e grupeve te keshilltareve.

Neni 71

Keshilltari ka te drejten e replikes. Replika eshte nje qendrim i paraqitur shkurt per permbajtjen e nje diskutimi te perfunduar. Replika behet menjehere pas diskutimit dhe nuk mund te vazhdoje me shume se 1 minute.

Neni 72

Per te njejtin diskutim nuk mund te behen me shume se dy replika. Pas replikave, keshilltari qe ka diskutuar ka te drejten e pergjigjes deri ne dy minuta.

Neni 73

Kryetari dhe Zv.Kryetari i Keshillit te Qarkut mund te marrin fjalen sa here qe te duan per diskutim por vetem njeri prej tyre per problemin qe diskutohet.

Neni 74

Te njejtin te drejte kane dhe drejtuesit apo keshilltare te caktuar ne emer te grupit te keshilltareve.

Neni 75

Kur lista emerore e diskutimeve ka perfunduar dhe asnje keshilltar nuk kerkon te diskutoje, kryetari shpall mbylljen e debatit.

Neni 76

Propozimi per nderprerjen e debatit hidhet ne vote perpara propozimit per shtyrjen e debatit.

Neni 77

Kur pranohet propozimi per nderprerjen e debatit, por ka kryetare grupesh qe nuk kakne diskutuar per problemin ne debat, fjala i jepet njerit nga keshilltares e cdo grupi.

Neni 78

Kur krijohet zhurme ose prishje rregulli ne mbledhjen e Keshillit ose pengohet ecuria normale e punes se tij, Kryetari mund te nderprese mbledhjen per 30 minuta vetem nje here.

Neni 79

Mbledhja e Keshillit te Qarkut mund te shtyhet me vendim te Keshillit dhe me propozim te Kryetarit ose te nje grupi keshilltaresh.

Neni 80

Ne cdo mbledhje te Keshillit mbahet procesverbal nga nje punonjes i caktuar dhe firmoset nga Kryetari, Sekretari dhe te pakten tre keshilltare te grupeve te ndryshme.

Neni 81

Procesverbali mund te mbahet edhe me stenografi dhe mjete te tjera rregjistrimi apo incizimi si magnetofoni. Ne keto raste, procesverbali hidhet ne leter dhe firmoset. Ne keto raste, shiritat e magnetofonit, ruhen deri ne nje vit.

Neni 82

Te gjitha aktet qe miraton Keshilli i Qarkut nenshkruhen brenda 10 diteve nga data e miratimit te tyre. Ne rastet kur jane bere gabime, ne hedhjen e akteve te keshillit, korrigjimi i tyre behet me urdher te kryetari te Keshillit, pasi degjohet titullari qe ka paraqitur aktin dhe referuesi nga komisioni qe ka paraqitur aktin.

Vendimet e Keshillit te Qarkut hyjne ne fuqi 10 dite pas shpalljes, kurse vendimet qe me karakter individual, hyjne ne fuqi ne daten e njoftimit te tyre subjekteve qe perfshihen me to.

Neni 83

Mbledhjet e Keshillit te Qarkut zhvillohen ne seanca qe zgjatin 1 ore e 30 minuta, midis seancave behet 20 minuta pushim.

KREU VII

Votimi

Neni 84

Votimi eshte vetjak. E drejta e votes, nuk mund te delegohet. Votimi behet i hapur ose i fshehte.

Neni 85

Votimi i hapur behet ne keto menyra:

- 1) Me ngritje dore
- 2) Me thirrjen e emrit (nominal)
- 3) Me ngritjen e kartonit me ngjyre te gjelber = pro, me ngjyre te kuqe = kunder dhe me ngjyre te bardhe = abstenim.

Neni 86

Per organizimin e votimit formohet nje komision i vecante me perfaqesues nga grupe te ndryshme keshilltaresh.

Neni 87

Ne rastet kur keshilli vendos qe votimi te behet i fshehte ne fleten e votimit duhet te shkruhet objekti i votimit dhe opsionet e votimit “Pro”, “kunder” dhe “abstenim”. Ne votim keshilltari shenon me kryq opsionin per te cilin ai eshte dakort. Fletet e votimit behen drejtepersedrejti ne keshill.

Neni 88

Cdo keshilltar ka te drejten e propozimit per percaktimin e menyres se votimit. Propozimi hidhet ne vote pa debat.

Neni 89

Kryetari shpall fillimin e procesit te votimit. Gjate procesit te votimin nuk i jepet fjala asnje keshilltari.

Neni 90

Votimi nominal behet me thirrje te keshilltareve. Drejtuesi i mbledhjes ose sekreteri i therret keshilltaret sipas listes dhe ata pergjigjen “Pro”, “Kunder”, “Abstenim”.

Neni 91

Sipas nevojës, drejtuesit e grupeve mund te kerkojne para fillimit te votimit te terhiqet grupi per konsultime me nje afat deri ne 10 minuta, pas kesaj, fillon votimi.

Neni 92

Ne fillim behet votimi ne parim per aktin qe votohet. Pas kesaj, behet votimi per cdo propozim te bere sipas rradhes se paraqitjes se tyre.

Neni 93

Keshilli mund te vendose qe votimi mund te behet vecas per cdo pike te projektit te paraqitur. Ne rradhe te pare hidhet me vote propozimi per heqjen fare te pikes (kur ka propozime te tilla) dhe pastaj votohet per ndryshime e plotesime te tij.

Neni 94

Propozimet quhen te miratuara kur per te voton me shume se gjysma e anetareve te pranishem me perjashtim te rasteve te parashikuara me ligj.

Neni 95

Ne rast parregullsie ne votim, si dhe kur numri i votave “Pro” eshte i barabarte me nurmin e votave “kunder”, votimi perseritet. Votimi i dyte eshte perfundimtar.

Neni 96

Vendimet e Keshillit te Qarkut merrren me shumicen e votave te anetareve te tij te pranishem ne mbledhje, me perjashtim te rasteve te percaktuara ne nenin 77 , shkronjata a “b”, , “ë”,’f “g”, “gj”, “ll” te ligjit nr 139/2015 ‘per vetqeverisjen vendore “qe kerkojne votat e me shume se gjysmes se numrit te pergjithshem te anetareve te keshillit.

Kreu VIII

Procedura e paraqitjes se projekteve ne Keshillin e Qarkut

Neni 97

Kryetari i Qarkut, Komisionet e perhershme, keshilltare te vecante paraqesin ne Keshillin e Qarkut projekt-vendimet dhe projekt-urdheresat.

Neni 98

Projektet se bashku me relacionet perkatese, ku jepen sqarime per motivet se perse propozohet akti dhe per menyren e zgjidhjes se ceshtjeve te vecanta, i drejtohen Kryetarit te Keshillit te Qarkut dhe rregjistrohen ne librin e akteve te Keshillit.

Neni 99

Kryetari i Keshillit (nepermjet Sekretarit) u shperndan projektet komisioneve te perhershme ne perputhje me karakterin e perkatesine e tyre, duke percaktuar cili komision do te jete kryesori ne paraqitjen e vendimeve ne keshill.

Neni 100

Komisioni kryesor organizon dhe koordinon shqyrtimin e projektit, ndjek ruajtjen e afateve dhe pergatit raportin per mbledhjen e Keshillit te Qarkut.

Neni 101

Komisionet e interesuara gjithashtu japin mendime per projektet e marra dhe ja drejtojne ato Kryetarit (duke ja dorezuar sekretarit) gjithmone para dites se shqyrtimit te projektit ne Keshill.

Neni 102

Komisionet e perhershme ne raportet qe paraqesin, deklarohen per domosdoshmerine e aktit, dobine e tij, mundesite financiare per plotesimin e tij. Ato bejne propozime te argumentuara para Keshillit te Qarkut per ta pranuar ashtu sic eshte apo duke i bere ndryshime, plotesime apo per te mos e pranuar.

Neni 103

Kur paraqitesi i projektit nuk eshte dakort me raportin e komisionit, ai mund te paraqese ne Keshill nje raport plotesues.

Neni 104

Projekt vendimet dhe projekt urdheresat shqyrtohen ne keshill pas raportimeve qe ben paraqitesi i tyre dhe komisionet perkatese ne rastet e kunderta (kur nuk paraqitet nga drejtorite apo komisioni), keshilli duhet te bindet per domosdoshmerine e aktit dhe te projektit te paraqitur.

Neni 105

Kur keshilli e shoh te arsyeshme, merr vendim per shqyrtimin e projektit pasi ai te plotesohet me tej. Ne kete rast, ai cakton kohen e shqyrtimit dhe ne rastet me te rralla e parashikon per ne rendin e dites se mbledhjes se ardhshme.

Neni 106

Ne kete rast, per plotesimet qe do te behen, ndiqet e njejta rruge pergatitore, si me projektin fillestar. Projekti fillestar nuk i jepet paraqitesi me perjashtim te rastit kur bie dakort vete keshilli me te drejten qe edhe raporti i pare ti rikthehet keshillit.

KREU IX

Raportet e keshilltareve me kryetarin e Qarkut.

Neni 107

Ne mbledhjen e Keshillit te Qarkut, keshilltaret mund ti drejtojne pyetje kryetarit te Qarkut ose Zv.Kryetarit. pyetjet duhet te jene te qarta, te shkurtra dhe te kerkojne informatat e domosdoshme per sqarimin e problemeve.

Neni 108

Ne rast se pyetjet kane te bejne me probleme, per te cilat nevojitet kohe per nxjerrjen e te dhenave sqaruese pyetjet behen jo me vone se nje dite perpara. Kur pyetjet behen me shkrim, kryetari ka te drejte te kerkoje kohen e duhur per pergatitjen e te dhenave. Ne rend te dites mund te futet edhe dhenia e pergjigjeve te pyetjeve nga kryetari i Qarkut.

Neni 109

Keshilltari qe ka bere pyetjen ka te drejte te shprehet nese pergjigjen nga kryetari i Qarkut e do me shkrim apo me goje.

Neni 110

Ne raste kur keshilltari qe ka bere pyetje paraprakisht mungon, kryetari i Qarkut nuk pergjigjet.

Neni 111

Autori i pyetjeve mund te terheqe pyetjet e bera me pare, duke u deklaruar ne mbledhje ose duke e paraqitur terheqjen me shkrim.

Neni 112

Kur fillohet nga pergjigja e pyetjeve te bera, keshilltari qe pyet mund te kerkoje paraprakisht te sqaroje ndonje ceshtje qe lidhet me shkaqet perse i ka lindur pyetja.

Neni 113

Kryetari i Qarkut ose zevendesi i tij te cilit i eshte bere pyetja, jep pergjigje me goje ose me shkrim.

Neni 114

Pas perfundimit te pergjigjeve, keshilltari qe ka bere pyetjen, ka te drejten te beje pyetje plotesuese per sqarimin e problemeve. Gjate pergjigjes se pyetjeve nuk lejohet te behet debat.

Neni 115

Pas perfundimit te pergjigjeve te pyetjeve qe ka bere, keshilltari ka te drejten e replikes, duke dhene kosnideraten e tij per pergjigjen e dhene.

Neni 116

Kryetari i Keshillit te Qarkut e ka te detyruar pjesemarrjen ne mbledhjen e Keshilli i Qarkut, ne mungese te tij mbledhjen e drejton Zv.Kryetari.

Neni 117

Per miratimin, ndryshimin dhe plotesimin e kesaj rregulloreje nevojiten votat e shumices se anetareve te pranishem ne mbledhjen e Keshillit te Qarkut.

KRYETAR I KESHILLIT

Evis SEMA